



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Durrës, më \_\_\_ / \_\_\_ / 2021

## RAPORT VJETOR I PUNËS

### SË SEKTORIT TE KONTROLLIT SHTETËROR PORTUAL

Spektori i Kontrollit Shtetëror Portual(KSHP) kryen veprimtarinë e tij duke u bazuar ne Ligjin nr. 9251 dt.08.07.2004 “**Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë**”, Ligjin nr.10109 date 02.04.2009, “**Për administratën detare të RSH**”,Ligjin nr.9852,date 26.12.2007“**Per Aderimin e Shqipërisë në Memorandumin e Mirkuptimit per Kontrollin Shtetëror Portual**”,Vendimit nr.13,date 11.01.2017 per Miratimin e Rregullores” **Per Kontrollin Shtetëror Portual ne Republikën e Shqipërisë**”

Gjatë vitit 2020 Spektori Kontrollit Shtetëror Portual ka realizuar një volum të konsiderueshëm pune persa i përket zbatimit të programit vjetor të punës për kryerjen e inspektimeve në anijet me flamur të huaj që prekin portet e hapura të RSH.

**1-Gjatë muajit Janar** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 27 anije mallrash të përgjithshme,7 anije konteniere, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 8 cisterna.Në portin PIA në Vlorë janë përpunuar gjithsej 8 cisterna,në portin Vlorë 1 anije mallrash.Në portin e Sarandës eshte perpunuar 1 anje mallrash ,në total 52 anije .Në portin Shëngjin gjatë këtij muaji nuk janë përpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 13 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës,të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së, në Porto Romano dhe MBM është inspektuar 1 cisternë, ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim.Numri i anijeve të inspektuara përbën 26% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**2-Gjatë muajit Shkurt** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 33 anije mallrash të përgjithshme, 6 anije konteniere, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 13 cisternë.Në portin PIA në Vlorë janë përpunuar gjithsej 8 cisterna,në portin Vlorë 0 anije mallrash.Në portein e Shengjinit janë perpunuar 1

anije mallrsh dhe 1 cisternë .Ne portin Sarande është perpunuar 1 anije mallrsh me flamur të huaj, në total 63 anije

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 14 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës,të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM janë inspektuar 4 cisternë. Në portein e Shengjinit janë perpunuar 1 anije mallrash dhe një cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim.Numri i anijeve të inspektuara përbën 31.7% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**3-Gjatë muajit Mars** në portin Durrës janë perpunuar gjithsej 35 anije mallrash, dhe 08 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë perpunuar 08 anije cisterna, në portin Vlore është perpunuar 1 anije mallrash të përgjijshme,ndërsa në Terminalin PIA 7 cisterna. Ne portin Sarande janë perpunuar 3 anije mallrsh me flamur të huaj, në total 62 anije Në portin Shëngjin gjatë këtij muaji nuk janë perpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 7 inspektime në bordin e anijeve më flamur të huaj në portin Durrës të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së,ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim.Numri i anijeve të inspektuara përbën 11.1% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH duke plotësuar kështu edhe kërkesat e rregullores.

**4-Gjatë muajit Prill** në portin Durrës janë perpunuar gjithsej 28 anije mallrash, dhe 13 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë perpunuar 10 anije cisterna, në portin Vlorë Është perpunuar 1 anije mallrash, në Terminalin PIA janë perpunuar 4 anije cisternë. Ne portin Sarande janë perpunuar 2 anije mallrsh me flamur të huaj,në total 58 anije. Në portin Shëngjin nuk janë perpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 10 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës,të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM janë inspektuar 2 cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim.Numri i anijeve të inspektuara përbën 20.6% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**5-Gjatë muajit Maj** në portin Durrës janë perpunuar gjithsej 22 anije mallrash, dhe 13 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë perpunuar 9 anije cisterna, në portin Vlorë janë perpunuar 1 anije mallrash , në Terminalin PIA janë perpunuar 6 anije cisternë,në total 55 anije .Ne portin Sarande janë perpunuar 4 anije mallrsh me flamur të huaj, në total 55 anije .Në portin Shëngjin nuk janë perpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 12 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës,të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM janë inspektuar 4 cisternë. Në portin e Sarandës është inspektuar një anije mallrsh.Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim.Numri i anijeve të inspektuara përbën 30.9% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**6- Për muajin Qershor** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 30 anije mallrash, dhe 10 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 9 anije cisterna, në portin Vlorë nuk janë përpunuar anije mallrash, në Terminalin PIA janë përpunuar 4 anije cisternë, më total 47 anije. Ne portin Sarandë janë përpunuar 4 anije mallrash me flamur të huaj, në total 57 anije. Në portin Shëngjin nuk janë përpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 17 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës, të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM është inspektuar 1 cisternë. Në portin e PIA Vlorë është inspektuar një anije cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim. Numri i anijeve të inspektuara përbën 33.3% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**7-Gjatë muajit Korrik** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 28 anije mallrash të përgjithshme, 06 anije konteniere, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 09 cisterna. Në portin PIA në Vlorë janë përpunur gjithsej 6 cisterna, në portin Vlorë 1 anije mallrash. Ne portin Sarandë është përpunuar 1 anije mallrash me flamur të huaj, në total 51 anije. Në portin Shëngjin gjatë këtij muaji nuk janë përpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 20 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës dhe 1 anije konteniere të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM është inspektuar 2 cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim. Numri i anijeve të inspektuara përbën 47.0% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**8-Gjatë muajit Gusht** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 21 anije mallrash të përgjithshme, 09 anije konteniere, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 6 cisterna. Në portin PIA në Vlorë janë përpunur gjithsej 9 cisterna, në portin Vlorë është përpunuar 1 anije mallrash, Ne portin Sarandë janë përpunuar 2 anije mallrash me flamur të huaj, në total 48 anije. Në portin Shëngjin gjatë këtij muaji nuk janë përpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 9 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës, të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM është inspektuar 1 cisternë. Në portin e PIA Vlorë janë inspektuar 4 anije cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim. Numri i anijeve të inspektuara përbën 29.1% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**9-Gjatë muajit Shtator** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 31 anije mallrash, dhe 10 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 11 anije cisterna, në portin Vlorë nuk janë përpunuar anije dhe në Terminalin PIA 8 cisterna. Ne portin Sarandë është përpunuar 1 anije mallrash me flamur të huaj, në total 61 anije. Në portin Shëngjin gjatë këtij muaji nuk janë përpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 17 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës, të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në portin e PIA Vlorë

është inspektuar 1 anije cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim. Numri i anijeve të inspektuara përbën 29.5% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**10-Gjatë muajit Tetor** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 26 anije mallrash, dhe 10 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 11 anije cisterna, në portin Vlorë është përpunuar 1 anije mallrash, në Terminalin PIA janë përpunuar 9 anije cisternë. Në portin Sarandë janë përpunuar 3 anije mallrash me flamur të huaj, në total 60 anije. Në portin Shëngjin nuk janë përpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 12 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës dhe 2 anije kontiniere të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM janë inspektuar 3 cisternë. Në portin e PIA Vlorë janë inspektuar 3 anije cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim. Numri i anijeve të inspektuara përbën 30% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**11-Gjatë muajit Nëntor** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 28 anije mallrash, dhe 6 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 11 anije cisterna, në portin Vlorë nuk është përpunuar asnjë anije mallrash , në Terminalin PIA janë përpunuar 9 anije cisternë. Në portin Sarandë janë përpunuar 2 anije mallrash me flamur të huaj. Në portin Shëngjin është përpunuar 1 tanker me flamur të huaj, në total 57 anije.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 12 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës , të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. , Në Porto Romano dhe MBM janë inspektuar 4 cisternë. Në portin e PIA Vlorë janë inspektuar 3 anije cisternë. Në portin Shëngjin është inspektuar 1 anije cisternë. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim. Numri i anijeve të inspektuara përbën 33.3% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**12- Gjatë muajit Dhjetor** në portin Durrës janë përpunuar gjithsej 23 anije mallrash, dhe 9 kontenierë, në Porto Romano dhe MBM janë përpunuar 9 anije cisterna, në portin Vlorë nuk është përpunuar asnjë anije mallrash , në Terminalin PIA janë përpunuar 10 anije cisternë, Në portin Sarandë janë përpunuar 3 anije mallrash me flamur të huaj, në total 46 anije. Në portin Shëngjin nuk janë përpunuar anije me flamur të huaj.

Gjatë këtij muaji janë kryer gjithsej 14 inspektime në bordin e anijeve me flamur të huaj në portin Durrës , të cilat i përmbushnin kriteret për inspektim sipas rregullores së KSHP-së. Në portin e PIA Vlorë janë inspektuar 3 anije cisternë. Në portin Sarandë është inspektuar 1 anije mallrash. Ndërsa për portet e tjera nuk kemi patur raste për inspektim. Numri i anijeve të inspektuara përbën 33.% të anijeve që kanë prekur portet e hapura të R.SH.

**Gjatë periudhës vjetore Janar-Dhjetor 2020 kanë prekur portet e hapura të Republikës së Shqipërisë, të paktën një herë, dhe janë përpunuar gjithsej 694 anije me flamur të huaj të tipeve të ndryshme, përveç anijeve pasagjere të linjës. Sektori i Kontrollit Shtetëror Portual nëpërmjet**

**inspektorëve dhe specialistëve që ka në organikë gjatë kësaj periudhe ka kryer gjithsej 200 inspektime në anije konteniere,tankera dhe të mallrave të përgjithshme,që përkon me 28.81% të numrit total të anijeve që kanë prekur këto porte , Krahësuar me vitin 2019 numri i inspektimeve për këtë vit është rritur me 47 anije më shumë.Kjo shifer do të ishte më e lartë por për shkak të pandemisë dis anije nuk u inspektuan.**

Gjatë planifikimit të inspektimeve vëmendje kryesore i është kushtuar anijeve që prekin portet e hapura të RSh për herë të parë,anijeve me moshë më të madhe se 12 vjet si dhe anijeve të cilat e kanë të ndaluar të futen në portet e shteteve të Komitetit Evropian.Ky grup anijesh konsiderohet me performancë të lartë rrisht (high risk). Janë inspektuar të gjitha anijet me këtë performancë,përvec rasteve kur ky tip anijesh është përpunuar gjatë ditëve të pushimit në fundjavë apo ditëve të pushimeve zyrtare, si dhe gjate muajit mars – prill për shkak të pandemisë u ndërpre puna.

Përsa i përket inspektimit të anijeve konteinere sektori jonë ka hasur vështirësi në inspektimin e tyre për arsyen se këto tip anijesh përpunohen në një kohë shumë të shkurtër , natën dhe ditët e pushimeve ,e cila e bën realisht të vështirë inspektimin e plotë të tyre. Nga informacionet dhe kontaktet që kemi me inspektorë të vendeve anëtare të Paris MoU, rezulton se edhe këto vende shprehin të njëjtin shqetësim përsa u përket inspektimit të anijeve konteniere.

Përsa i përket inspektimit të anijeve cisternë,nga ana e sektorit tonë këtë vit është rritur numri i inspektimeve të kryer. Pjesa më e madhe e këtyre anijeve që përpunohen në терминаlet tona janë prodhime të viteve të fundit me moshe 2-5 vjecare.

Gjatë inspektimeve te kryera është vërejtur se një pjesë e konsiderueshme e anijeve që prekin portet e hapura te RSh kanë një moshë relativisht të madhe. Vërehet gjithashtu se keto anije,panvaresisht moshës se tyre, frekuentojne rregullisht porte të ndryshme vendeve te BE-se, si dhe u jane nënështuar inspektimeve të rregullta nga inspektoreve te PSC te atyre vendeve.

Mbas inspektimeve të kryera është vënë re se, përgjithësisht anijet nuk kanë mungesa në dokumentacionin e tyre apo në dokumentacionin e ekuipazhit. Pjesa më e madhe e anijeve të inspektuara,kryesisht ato me moshë me te madhe, kane pasur probleme me mirmbajtjen e përgjithshme te anijes pasi në shumë raste vihet re prezenca e ndryshkut në bordet kryesore të tyre,apo korrodime te pjesëve te ndryshme te saj.Gjatë kësaj periudhe nje nga problematikat pothuajse në të gjitha anijet ka qënë se ekuipazhet e tyre punuan me kontratë më të zgjatur se normalishtn kjo për arsyen se ishin nderprerë fluturimet per atdhesimin e tyre.Gjatë inspektimeve të kryera vëmendje të veçantë i është kushtuar pajisjeve dhe çertifikimit të mjeteve të shpëtimit të jetës në det,të mjeteve të luftës kundër zjarrit,si dhe kushteve të punës dhe të jetës të ekuipazhit,të cilat,përgjithësisht,në të gjitha anijet e inspektuara kanë qënë relativisht të mira konform rregullave nderkombëtare detare të përcaktuara në Konventat përkatëse të IMO.

Në një pjesë të mirë të anijeve të inspektuara janë gjetur mangësi të ndryshme,por në asnjë rast, mangësitë e gjetura nuk kanë qënë rast i paster për bllokimin e anijes.I është lënë detyrë kapitenit të anijes që eleminimi i mangësive të kryhet në portin e destinacionit ose në një periudhë dy javore nga data e inspektimit.

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2020 janë inspektuar 24 anije pasagjer qe operojnë në linjë të regullt në portet e hapura të R.SH. Inspektimet janë kryer për efekt të licensimit si dhe inspektime rutine. Nga inspektimet e kryera në anije pasagjere është bllokua pasi gjate inspektimit nuk u gjet konform standarteve nderkombëtare të përcaktuara nga konventat e ndryshme të dala nga IMO, mbasi i plotësoi të gjitha gjetjet u la e lirë. Ne anijet e tjera mangesite e gjetura ishin në një nivel shumë të vogël risku dhe pjesa më e madhe e tyre u eliminuan përpara përfundimit të inspektimit.Janë planifikuar për tu inspektuar edhe tragetet e linjës Vlorë-Brindisi-Vlorë dhe Sarandë-Korfuz-Sarandë.

Theksojmë se të gjitha inspektimet e kryera në portet e hapura të RSh-së jane kryer bazuar në planin ditor te miratuar dhe në asnjë rast nuk jane kryer inspektime të iniciuara nga informacione të mara nga faktorë të tjerë të cilet operojnë në fushen e detarisë.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 në asnjë nga portet e hapura të RSH dhe në radat e tyre nuk kemi patur incidente apo aksidente të shkaktuara nga anijet me flamur të huaj,si dhe nuk ka patur raste të ndotjes së mjedisit ujor me mbetje vajore apo të naftës.

Në muajin korik inspektorët/specialistët e sektorit të Kontrollit Shtetëror të Flamurit u paisën me stampa identifikuese të cilat do ti përdorin gjatë lëshimit të raportit të inspektimit në bord të anijes.

Gjate muajit Nëntor Sektori i KSHP zhvilloi me sukses një program trajnimi Practical Exercise on PSC & MoUs Inspections (IMO Model Course 3.09) on line të planifikuar nga EMSA. Dhe në përfundim të trajnimit të gjithë inspektorët u paisën me certifikaten përkatëse.Gjatë muajit Nentor -Dhjetor u zhilluan trajnime on line të planifikuara nga UNDP. Më datën 04.12.2020 në ambjentete e APD u organizuan Ëorkshopi me temë Legjislacioni Detar, Menaxhimi Portual,Procedurat që ndjekin Kapiteneritë,STCË, Amendamentet e Manilës si dhe Monitorimi i RO. E planifikuar nga UNDP.

Përvec inspektimeve në anije,inspektorët apo specialistë e sektorit të KSHP kanë marë pjesë edhe në grupe pune të ngritura nga Drejtori i Përgjithshëm për kryerjen e detyrave të ndryshme në funksion të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme. Gjatë sezonit turistik veror,në muajin Gusht,në portin Sarandë, inspektorët e sektorit të KSHP, me qëllim mbarvajtjen e aktivitetit turistik,u dërguan me shërbim pranë kapitenerisë së këtij porti,kjo rezultoi shumë pozitive dhe e vlefshme për mbarvajtjen e aktivitetit turistik .

Përsa i përket inspektorëve dhe specialistëve të KSHP,performanca e tyre në punë përgjithësisht ka qënë e kënaqshme duke treguar profesionalizëm gjatë kryerjes së detyrës në bordin e anijeve,kjo bazohet edhe me faktin që në asnjë rast nuk ka patur ankesa nga kapitenët apo agjensitë e anijeve që janë inspektuar.Prezenca në punë ka qënë e plotë,përvec rasteve të justifikuara për pjesmarje në angazhime të tjera të planifikuara.Inspektorët dhe Specialistët e KSHP I kanë zbatuar pa hezitim të gjitha detyrat e përcaktuara në formularin e performancës së tyre,si dhe të gjitha urdhrat e dhëna për kryerjen e detyrave të ndryshme.

Për vitin në 2021 në vazhdim, një nga Objektivat e Sektorit të KSHP,e cila na është premtuar, është që personeli I KSHP të ndjek kurset e trajnimt së bashku me inspektorët e vendeve anëtare të Paris MoU

dhe sipas metodikave të tyre,që për ne do jetë risi.Kjo do të na mundësojë që Sekretariati I Paris MoU të na mundësojë të kemi akses në “THETIS”dhe do të hapë rrugën për tu antarësuar në këtë organizatë.

Në përfundim,duke marë për bazë detyrën dhe funksionin kryesor që sektori jonë ka, konkludojmë se sektori jonë për vitin 2020 I ka realizuar objektivat e paracaktuara duke rritur numrin e inspektimeve që ka kryer këtë vit në krahasim me vitin që shkoi me rrjedhojë parandalimin e incidenteve dhe aksidenteve dhe të mjedisit detar.

Bashkëlidhur lista me të dhenat e anijeve të inspektuara për vitin 2020.

## **SEKTORI I KONTROLLI SHTETEROR PORTUAL**

**Kastriot Sali**

**Shefi i Zyres**